

Qeverisja Vendore në Shqipëri

1. Kuadri legjislativ i vetë-qeverisjes vendore:
 - Garancitë kushtetuese
 - Legjislacioni
2. Karakteristikat e strukturës bazë të autoriteteve vendore:
 - Ndarja territoriale - numri i njësive të territorit;
 - Qarqet, Bashkitë dhe Komunat.
3. Organet e qeverisjes vendore - përberja, funksionet bazë:
 - Organet përfaqësuese (këshillat bashkiake);
 - Organet ekzekutive, struktura e administrimit bashkiak;
 - Bashkëpunimi ndërmjet dy llojeve të qeverisjeve.
4. Funksionet bashkiake sipas sferës së aktivitetit dhe llojeve të shërbimeve vendore:
 - Policia;
 - Edukimi;
 - Shëndeti;
 - Mirëqenia sociale dhe mbrojtja sociale;
 - Kultura;
 - Furnizimi me ujë dhe kanalizimi i ujërave të zeza;
 - Pastrimi dhe mbeturinat;
 - Strehimi;
5. Pronësitë bashkiake:
 - Ndarja sipas tipeve të pronave
 - Format e drejtimit
6. Financa e bashkisë
 - Të ardhurat nga buxhetet bashkiake - taksat vendore, kuotat vendore, taksat e ndara, huatë, subvencionet.
 - Shpenzimet e buxhetit bashkiak - llojet e aktiviteteve (ref. pika 4), kostot e investimeve dhe kostoja e tanishme (e ditës)
7. Bashkëveprimi ndërmjet autoriteteve vendore dhe qendrore:
 - Kontrollimi i qeverisjes vendore nga autoritetet qendrore;
 - Format e dialogut;
 - Bashkimi i qeverisjeve vendore për mbrojtjen e interesave të përbashketa..
8. Pjesëmarrja e qytetarëve në vetë-qeverisjen vendore:
 - Zgjedhjet vendore;
 - Format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë - referendumet, etj.
9. Reformat e ardhshme në vetë-qeverisjen vendore.

Qeverisja vendore në Shqipëri

Pak histori

Qeverisja vendore në Shqipëri ka filluar shekullin e kaluar. Fillimet e institucionit të bashkisë së Shkodrës i gjejmë në vitin 1865 kur Porta e Larte po përpiqej të realizonte disa reforma. **Beledija** sic quhej në atë kohë intitucioni i bashkisë kishte kompetenca minimale dhe personel të kufizuar. Ajo merrej me ruajtjen e rendit dhe të pastërtisë së qytetit, kontrollin mbi cmimet e artikujve që trëgëtoheshin dhe vjeljen e taksave. Pas mbarimit të luftës së I-rë botërore mori emrin "Perlimtare"

Para viteve 90` ajo ishte një qeverisje e dekoncentruar, me organe të kufizuara vetë - qeveritëse (Këshillat popullore).

Pas zgjedhjeve politike të 31 Marsit 1991 u formuan me ligj komitetet ekzekutive pluraliste të përkoheshme. Ato u bazuan në rezultatet e zgjedhjeve për deputet në kuvendin popullor dhe përgjithësisht u ngritën me konsensusin e partive politike. Më 26 Korrik 1992 u zhvilluan për herë të parë zgjedhjet e lira shume partiake për organet e pushtetit lokal. Krijimi i një kuadri ligjor ne vitin 1992 bëri te mundur për herë te parë krijimin e një autonomie politike të Qeverisjes Vendore. Megjithëse në atë kohë mungonte një autonomi administrative dhe fiskale organet e qeverisjes vendore filluan të merreshin me probleme të tilla si :

- Furnizimi i popullsisë me ushqime, kryesisht me bukë dhe artikujt e shportës
- Shpërndarja e ndihmave humanitare dhe mjekësore
- ruajtja e rendit dhe qetësisë publike
- Furnizimi me energji elektrike dhe ujë të pijshëm
- Ndarja e tokës bujqësore në fshatra

Ndryshimi kryesor strukturor në këtë kohë ishte përvijimi i rolit te dy niveleve të qeverisjes vendore:

- i) Bashkive, Komunave iu shtuan funksionet, si organe të nivelit të parë të qeverisjes me përgjegjësi të drejtperdrejta dhe me më shumë autoritet;
- ii) Këshilli i rrethit si një organ me një rol me shume koordinativ.

Në atë kohë numëroheshin 44 bashki, 316 Komuna dhe 36 rethe.

Në vitet e para të tranzicionit, vëmendja u përqëndrua kryesisht në reformat qëndrore për ngritjen e institucioneve kryesore (legjislativit, ekzekutivit, gjyqësorit) sipas modeleve demokratike, si dhe në reformat bazë ekonomike (stabiliteti makroekonomik, sistemi bankar, privatizimi, etj). Si rrjedhim, vëmendja dhe kujdesi për reformat në qeverisjen vendore qe më i ulët.

Në mars të 1997 Shoqata e Bashkive deklaroi se mbështet Qeverinë e Stabilitetit e cila disa javë më vonë deklaroi se do të bashkëpunojë me njësitë e organeve zgjedhore dhe Shoqatën e tyre. Pak muaj më vonë Presidenti i Republikës z. Rexhep Mejdani përshëndet Shoqatën e Bashkive dhe fillon një korendiment të dendur leterkëmbimesh.

Kryetari i Shoqatës së Bashkive nënshkruan në 3 Nëntor 1997 një marrëveshje me Kryetarin e Grupit Parlamentar të PS me qëllim që të bashkëpunojnë për "*ndryshimin e kuadrit ligjor që ka të bëjë me Pushtetin Lokal*".

Njohja e Shoqatës me Kongresin Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Europës (CLRAE) si dhe me Kartën Europiane së Autonomisë Vendore bëri të mundur që

Shoqata të kërkojë zyrtarisht nënshkrimin e Kartes . Këshilli i Ministrave mori Vendim dhe caktoi z. Bashkim Fino për ta nënshkruar atë në vitin 1998 . Nënshkrimi i Kartës që një fitore për autonominë vendore sepse solli krijimin e Komitetit të Decentralizimit si dhe Grupit Teknik të Ekspertëve për Decentralizimin të cilët hartuan Strategjinë e Decentralizimit e cila përcakton ndërmjet të tjerave synimet e përgjithshme dhe objektivat e decentralizimit .Produkt i saj ishte hartimi i ligjit Nr.8652, datë31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" i cili është një nga ligjet më të përparura në fushën e decentralizimit të pushtetit krahasuar me vendet e Europës Lindore.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave caktohet për herë të parë delegacioni shqiptar në CLRAE i cili është organi përfaqësues lokal dhe rajonal i Këshillit të Europës dhe ka për qëllim të mbështesë dhe promovojë autonominë financiare , politike dhe administrative të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale duke inkurajuar qeveritë qendrore të zhvillojnë efektivisht demokracinë vendore. Kongresi monitoron zbatimin e Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore e cila tashmë është një ligj shqiptar që nga Gushti i këtij viti . Këshilli i Europës me kërkesën e Shoqatës nxorri Rekomandimin 28 të vitit 1997 që sensibilizoi opinionin publik për domosdoshmërinë e respektimit të autoritetit të zgjedhurve lokal dhe shumë shpejt grupime politike u shprehën për bashkëjetesë të organeve qendrore dhe vendore .

1. KUADRI LEGJISLATIV I VETE - QEVERISJES VENDORE

1.1 Garancitë kushtetuese

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar në 1998(pas një referendumi) thuhet se Shqipëria është një shtet unitar dhe i pandashëm dhe në parimet e përgjithshme të saj shkruhet shprehimisht se : "*Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet mbi parimin e decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore*".

Kapitulli i 6 i Kushtetutës parashikon se:

1. **Bashkitë dhe Komunat janë njësitë bazë të qeverisjes vendore.**
2. **Qarku** është niveli më i lartë i vetë qeverisjes vendore.

Kushtetuta e bën të qartë se njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë dhe i jep të drejtën të:

- a. rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre;
- b. ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike;
- c. kanë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre;
- d. kanë të drejtë të vendosin , në përputhje me ligjin taksa vendore si dhe nivelin e tyre;
- e. caktojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre në pajtim me ligjin;
- f. krijojnë simbolet e qeverisjes vendore si dhe titujt vendorë të nderit;

g. ndërmarrin nisma për çështje vendore përpara organeve të caktuara me ligj.

Organet e njësive të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime, urdhra dhe të drejtat për vetëqeverisje të njësive të qeverisjes vendore mbrohen në gjykatë.

Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale ekonomike dhe sociale dhe është njësi ku ndërtohen dhe zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore.

Organet përfaqësuese të njësive vendore janë këshillat e tyre. Bashkitë dhe komunat delegojnë antarë në këshillin e qarkut në përpjestim me popullsinë e tyre dhe kryetarët e komunave dhe bashkive janë gjithnjë anëtarë të këshillit të qarkut.

Këshilli i qarkut ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese për qarkun.

Këshilli i Ministrave cakton prefektin si përfaqësues të tij në cdo qark, kompetencat e tij përcaktohen me ligj. Këshilli i Ministrave mund të shpërndajë apo shkarkojë organet e zgjedhura të njësive të qeverisjes vendore për shkelje të rënda të kushtetutës apo të ligjeve.

Organi i shpërnadarë apo i shkarkuar mund të ankohet në gjykatën kushtetuese brenda 15 ditëve dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministarve pezullohet .Në rast se Gjykata Kushtetuese le në fuqi vendimin e Këshillit të Ministrave, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve të parakohshme.

1.2. LEGJISLACIONI

Ligjet kryesore mbi administratën publike dhe pushtetin lokal.

Ligjet e mëposhtme rregullojnë marrëdhëniet në administratën publike dhe pushtetin lokal në Shqipëri :

- | | |
|--|------------------|
| 1. Ligji Për Prokurimin Publik | (nr. 7971; 1995) |
| 2. Ligji Për Organizimin e Policisë së Bashkisë e Komunës | (nr. 8224; 1997) |
| 3. Ligji Për Sistemin e Taksave në Republikën e Shqipërisë | (nr. 8435; 1998) |
| 4. Ligji Për Urbanistikën | (nr. 8405; 1998) |
| 5. Ligji Mbi Statusin e Nëpunësit Civil | (nr. 8549; 1999) |
| 6. Ligji mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore | (nr. 8652; 2000) |
| 7. Ligji Mbi Ndarjen Administrativo-Territoriale | (nr. 8653; 2000) |
| 8. Ligji Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Bashkisë së Tiranës. | |
| 9. Ligji Për Pronat e Paluajtëshme të Shtetit | (nr. 8743; 2001) |
| 10. Ligji Për Transferimin e Pronave Publike të Paluajtëshme të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore. | (nr. 8744; 2001) |

Ligji mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore (Ligji bazë është një ligji organik, pra i miratuar më 3/5 e Kuvendit) nr.8652, dt.31 07 2000 sanksionon kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e njësive të qeverisjes vendore.

Cdo njësi e qeverisjes vendore ka të gjitha tagrat të ushtrrojë inisiativa në interes të komunitetit lokal, përveç rasteve këto inisiativa janë kompetencë e ndonjë organi tjetër ose janë të ndaluara me ligj.

1. Duke iu referuar ligjit, njësitë e qeverisjes vendore gëzojnë këto të drejta:

I. E drejta e qeverisjes

- a) Përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave.
- b) Bazuar në Kushtetutë, në ligjet dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhëra që janë të detyrueshme për të gjitha subjektet e përfshira në akt, në juridiksionin e tyre.
- c) Krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi.
- ç) Krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre.
- d) Krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja.
- dh) Krijojnë nëndarje administrativo-territoriale brenda juridiksionit për rritjen e efikasitetit në kryerjen e funksioneve të tyre qeverisëse, sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj.

II. E drejta e pronësisë

- a) Njësitë e qeverisjes vendore, ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

III. E drejta e mbledhjes së të ardhurave dhe e bërjes së shpenzimeve

- a) Krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre.
- b) Vendosin taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë.

IV. E drejta e kryerjes së veprimtarive ekonomike

- a) Për përmbushjen e funksioneve publike në interes të bashkësisë që përfaqësojnë, ushtrojnë veprimtari ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit.

V. E drejta e bashkëpunimit

- a) Për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të bashkësisë përkatëse, dy osë më shumë njësi të qeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njera-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë.
- b) Bashkëpunojnë me njësi të qeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- c) Kanë të drejtë të organizohen në shoqata, në përputhje me legjislacionin përkatës për shoqatat.

VI. E drejta e personit juridik

Si persona juridike, njësitë e qeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi:

- a) të drejtën e lidhjes së kontratës;
- b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;
- c) të drejtën e ngritjes së padisë civile;
- ç) të drejtën e mbajtjes së llogarive;
- d) të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore.

KARAKTERISTIKAT BAZË TË AUTORITETEVE VENDORE

1. Ndarja territoriale – numri i njësisve të qeverisjes vendore.
2. Qarqet, Bashkitë dhe Komunat.

Në Shqipëri ka:

1. 12 Qarqe

Qarku është njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore.

Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa komuna dhe bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e komunave dhe të bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut vendoset në një nga bashkitë që përfshihen në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj.

2. 65 Bashki

Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banoresh kryesisht në zona urbane e në raste të veçanta përfshin edhe zona rurale. Shtrirja territoriale dhe emri i bashkisë përcaktohen me ligj. Nëndarjet e bashkisë në zona urbane quhen lagje. Lagjet krijohen në territore me mbi 15 000 banorë me vendim të këshillit bashkiak. Kur bashkia përfshin zona rurale, nëndarja quhet fshat. Fshati krijohet në një territor me mbi 200 banorë. Qytet, shpallet një qendër banimi e cila ka një plan perspektiv zhvillimi urban të miratuar. Shpallja e qytetit bëhet më ligj. Shqipëria ka 74 qytete nga të cilat vetëm 65 janë bashki.

3. 309 Komuna

Komuna përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkesi banorësh, si rregull në zona rurale dhe në raste të veçanta edhe në zona urbane. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e komunës përcaktohen me ligj. Nëndarjet e komunës quhen fshatra dhe në raste të veçanta qytete. Përcaktimi i territorit të nendarjeve bëhet nga keshilli komunal.

III.ORGANET E QEVERISJES VENDORE - PERBERJA, STATUTI, FUNKSIONET BAZË :

- **Organet përfaqësuese (këshillat bashkiakë)**
- **Organet ekzekutivë, struktura e administratës bashkiake;**
- **Bashkëveprim ndërmjet të dy llojeve të organeve**

Këshilli komunal dhe bashkiak përbëhen nga këshilltarë të zgjedhur sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Numri i anëtarëve të këshillit komunal dhe bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë

Komunat dhe bashkitë deri në 5000 banorë 13 anetarë

5000 -	10000 banorë	15 anetarë
10000 -	20000 banorë	17 anetarë
20000 -	50000 banorë	25 anetarë
50000 -	100000 banorë	35 anetarë
100000 -	200000 banorë	45 anetarë
Bashkia e Tiranës		55 anetarë

Funksioni i këshilltarit është i papajtuëshëm me funksionin e kryetarit, zëvendës kryetarit, sekretarit të këshillit komunal ose bashkiak dhe cdo nënpunësi të administratës së komunës ose bashkisë përkatëse.

Këshilli i Komunës ose ai i Bashkisë miraton:

- Statusin e komunës ose bashkisë si dhe rregulloren e brendshme të funksionit të vet.
- Strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat eshpërblimit të personave të tjerë të zgjedhur ose të emeruar
- Aktet e themelimit të ndërrmarrjeve, shoqërive tregtare si dhe personave të tjerë juridikë që i krijojnë vete ose është themelues
- buxhetin dhe ndryshimet e tij
- Norma, standarte e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj si dhe mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik
- Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara

Këshilli i komunës ose bashkisë zgjedh:

- Kryetarin ose Nenkryetarin e këshillit

Këshilli i komunës ose bashkisë vendos:

- taksat dhe tarifën vendore si dhe nivelin e tyre
- marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve
- krijimin e institucioneve të përbashkëta
- për fillimin e procedurave gjyqësore
- dhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit
- simbolet e komunës dhe bashkisë
- për emertimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të institucioneve dhe objekteve të tjera
- për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara

Këshilli i komunës ose bashkisë organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm. Kryetari i këshillit drejton mbledhjet e këshillit dhe nënshkruan aktet që nxjerr këshilli. Sekretari emërohet nga këshilli mbi bazën e propozimit të kryetarit të këshillit. Komuna dhe bashkia miratojnë strukturën organizative dhe rregulloren bazë të administratës në varësi të komunës apo bashkisë si dhe numrin e personelit, pagat etj. Kryetarët zgjidhen direkt nga banorët e komunës ose bashkisë. Mandati i kryetarit vërtetohet nga gjykata. Ai mund të shkarkohet nga këshilli i Ministrave.

Mandati i këshillit të komunës ose bashkisë është tre vjeçar.

Organi ekzekutiv është Kryetari i Bashkise ose i Komunës i cili ka këto kompetencat dhe detyra:

- ushtron të gjitha kopetencat në kryerjen e funksioneve të komunës ose të bashkisë me përjashtim të atyre që janë kopetencë e këshillit përkatës
- Raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme që kanë të bëjnë me funksionimin e komunës ose bashkisë
- Emëron dhe shkarkon Nenkryetarin, drejtuesit e ndërmarjeve dhe institucioneve që ka në bashki.
- Merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive
- Kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime kur vëren se çënohen interesat e komunitetit

Këshilli i bashkisë krijon komitetet e tij të përhershme.

Këshilli i Bashkisë miraton strukturën organizative të organeve ekzekutive të drejtuar nga Kryetari i Bashkisë.

Kryetari i Bashkisë emëron Nenkryetar(in)et e Bashkisë dhe pjesën tjetër të stafit vecse kur parashikohet ndryshe në ligjin nr.6549, date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Kryetari kryen funksionet politike dhe administrative të bashkisë si dhe përfaqëson bashkinë në marrëdhëniet me bashki dhe komuna të tjera si dhe me administratën shtetërore. Kryetari dhe Nenkryetarët e tij janë përgjegjës për ekzekutimin e akteve dhe vendimeve të marra nga Këshilli i Bashkisë .

Zyrat e bashkisë janë të ndara në departamente. Kryetari i Bashkisë ,Nenkryetarët bëjnë organizimin e punës në këto departamente. Ata bëjnë gjithashtu mbikqyrjen e këtyre departamenteve.

Vendimet që duhet të marrë Këshilli i Bashkisë janë të parapërgatitura më parë nga departamentet e ndryshme të bashkisë të cilat më pas dërgohen në komisionet e këshillit të bashkisë të cilët shqyrtojnë këto drafte për të arritur më pas në zgjidhjen përfundimtare .Pas kësaj Këshilli i Bashkisë merr vendimin përfundimtar, i cili më pas ekzekutohet nga kryetari i bashkisë ose nga zyrtarë të tjerë të administratës së bashkisë.

Funksionet e bashkisë sipas fushës së aktivitetit dhe llojeve të shërbimeve vendore.

Të drejtat dhe detyrimet e bashkive janë të përcaktuara në ligjin “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

Në këtë kuadër Komunitat Bashkitë dhe Qarqet kryejnë tre funksione kryesore :

- i. **Funksionet e veta** janë funksione të dhëna me ligj njësisive të qeverisjes vendore për realizimin e të cilave këto të fundit kanë përgjegjësinë dhe autoritetin të marri

- vendime dhe të përdore mjete për realizimin e tyre, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standarteve të pranuarra përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, shërbimi, investimi dhe rregullator.
- ii. **Funksionet e përbashkëta** janë funksione për të cilat qeverisja vendore ka përgjegjësinë e përbashkët të dalluar nga përgjegjësia e përbashkët e qeverisjes qendrore dhe këto funksione janë të shoqëruara proporcionalisht me kompetencat të cilat ushtrohen në mënyrë autonome.
 - iii. **Funksionet e deleguara** janë ato funksione të cilat Qeveria Qëndrore me ligj ose marrëveshje ia delegon njësisive të qeverisjes vendore për t'i ushtruar.

Komunat dhe bashkitë ushtrojnë këto funksione të veta:

I. Në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike:

- a) furnizimi me ujë të pijshëm;
- b) funksionimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara;
- ç) ndriçimi i mjediseve publike;
- d) funksionimi i transportit publik urban;
- dh) administrimi i varrezave dhe garantimi i shërbimit të varrimit;
- e) shërbimi i dekorit;
- ë) administrimi i parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike;
- f) grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave;
- g) planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

II. Shërbimet me karakter social, kulturor e sportiv:

- b) organizimi i veprimtarive sportive, çlodhëse e argëtuese dhe administrimi i institucioneve përkatëse;
- c) shërbimi social dhe administrimi i institucioneve si çerdhet, azilet, shtëpitë e fëmijëve, etj.

III. Zhvillimi ekonomik vendor:

- a) përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor;
- b) ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë;
- c) zhvillimi i biznesit të vogël, si dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse si panaire e reklama në vende publike;
- ç) organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme;
- d) shërbimi veterinar;
- dh) ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave e burimeve natyrore me karakter vendor.

IV. Rendi dhe mbrojtja civile:

- a) ruajtja e rendit publik për parandalimin e shkeljeve administrative dhe garantimi i zbatimit të akteve të komunës ose bashkisë;
- b) mbrojtja civile.

V. TË DREJTAT PRONËSORE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë njeh të drejtën e njësive të qeverisjes vendore të kenë pronat e tyre dhe të gjitha të drejtat pronësore brenda kufijve ligjorë.

Llojet e pronave vendore

Njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtën të kenë në pronësi prona të luajtshme apo tundshme dhe të paluajtshme apo të patundëshme.

Pronat e paluajtshme ndahen në : prona publike dhe prona të paluajtshme jo-publike.

Ndryshimi i statusit të një prone nga publike në jo-publike bëhet sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

Duke iu referuar ligjit 8743 Datë 22.2.2001 “për pronat e paluajtshme të shtetit”

Rregjistrimi i pronave të paluajtshme në emër të njësive të qeverisjes vendore bëhet nga këshilli i njësive të qeverisjes vendore.

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” pronat që u transferohen njësive të qeverisjes vendore që do të përdoren nga këto të fundit për realizimin e funksioneve ose shërbimeve për bashkësinë të njohura me ligj të tilla si:

- a) Pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve të tyre administrative
- b) Pronat që përdoren për realizimin e programeve arsimore
- c) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik
- d) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike
- e) Pronat që përdoren për kryerjen e veprimtarive social-kulturore e sportive.
- f) Pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.
- g) Pronat që përdoren për grumbullimin, depozitimin, pastrimin, dhe shpërndarjen e ujit si dhe për grumbullimin, depozitimin, pastrimin dhe shfrytëzimin e mbeturinave dhe ujrave të zeza.
- h) Pronat që përdoren për sistemimin e transportit publik.
- i) Pronat që përdoren si lehtësira të transportit vendor (urbane, rurale dhe ndërkombëtare), përfshirë rrugët, rrugicat, urat, aeroportet dhe portet vendore.
- j) Prona të tilla si trotuare, sheshe, rrjeti i ndriçimit publik, si dh pajisjet e tjera zbkuruese brendapërbrenda bashkive dhe komunave.
- k) Prona të tilla si mjete për funeral, varrezat brendapërbrenda bashkive dhe komunave.
- l) Prona të tilla si monumentet historike e kulturore dhe bustet me interes vendor.
- m) Prona të tilla si pyje, kullota, parqe dhe kopshte publike, që kanë për qëllim të përdoren për interes vendor.
- n) Prona të tilla si struktura dhe njësi rezidenciale me interes vendor.
- o) Prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi.

MENAXHIMI I ASETEVE.

Qeveritë vendore, brënda kufizimeve të përcaktuara me ligj, kane autoritet të plotë në lidhje me pronësinë të cilën e zotërojnë. Në veçanti, ata mund të vendosin për përdorimin e pronës, mund të blejnë apo të shesin, japin me qera agjensive private dhe publike, ta

shkëmbejnë, apo ta përodrin si kolateral, të menaxhojnë paketat (portofolet) të pasurisë së paluajtshme etj.

Regullat në lidhje me aktivitetet e menaxhimit të aseteve duhet të garantojnë transparencë të vendim-marrjes dhe të transaksioneve me pasuritë publike. Menaxhimi i pasurisë do të varet nga lloji i pasurisë dhe niveli i interesit public në të. Ligji duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat.

AUTORITETI I NË NIVEL VENDOR

Autoriteti për ushtrimin e të drejtave dhe menaxhimin e pronave përqëndrohet tek Këshilli Vendor, i cili do të nxjerre vendimi për aspekte të ndryshme të vendimeve. Këshilli Vendor ka autoritetin për të deleguar pjesë të kompetencave në organin ekzekutiv, veçanarisht ato të cilat lidhen me operimin dhe menaxhimin e pronave.

Me 22 Shkurt 2001 Parlamenti aprovoi ligjin “Mbi Pronat e Paluajtshme të Shtetit” dhe ligjin “Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

Mekanizmat e fitimit të pronave

Qeveritë vendore kanë të drejtë të fitojnë prona nga :

Blerja e pronave

Shkëmbimi i pronave me agjenci të tjera

Ngritja e ndërmmarrjeve

Dhurime

VI. FINANCAT BASHKIAKE

Financat Bashkiake ndahen në:

1. të ardhurat e buxhetit bashkiak - taksat vendore, tarifatat vendore, taksat e perbashkëta, dhe kreditë.
2. shpenzimet e buxhetit bashkiak – të ndara sipas llojit të aktiviteit (referoju pikës 4), kostot aktuale dhe ato të investimeve.

Ligji “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” shpreh

Klasifikimi i taksave vendore, bazuar në llojin e tyre, është:

1. Për taksën për regjistrimin e veprimtarisë private	0 për qind
2. Për taksën e pastrimit, largimit dhe kompostimit të mbeturinave	5 për qind
3. Për taksën e tregut për zënie vendi	5 për qind
4. Për taksën e gjuetisë dhe peshkimit amator	5 për qind
5. Për taksën e fjetjes në hotel të të huajve	0 për qind
6. Për taksën e reklamës	5 për qind
7. Për taksën për çdo bagëti të therrur	5 për qind
8. Për taksën për ndërtime të reja	5 për qind
9. Për taksën e tabelës	5 për qind
10. Për taksën e bashkisë për xhiron e hoteleve, ëmbëltove, diskotekave, restoranteve dhe kafeneve	0 për qind
11. Për taksën për mbajtjen e qenve të luksit	5 për qind
12. Për taksën për regjistrimin e vendbanimit të ri	0 për qind
13. Për taksën për parkimin e automjeteve	5 për qind

Këto 13 taksa vendore dhe mbledhja e tyre nuk bëhet vetëm brenda ndertësës së Bashkisë apo nga agjenti taksa- mbledhës, i cili është i vendosur jashtë ndertësës së Bashkisë. Disa pagesa behen në banke apo në zyrtarë të TELEKOM-it (ku përfshihet dhe komisioni dhe vlera e fatures)

Bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe Degës së Tatimit Taksave të Rrethit ka qënë më i mirë se në vitet e mëparshme. Kjo ka ndodhur si rezultat i një urdhëri të lëshuar nga Kryeministri, ku thuhet se asnjë biznes nuk do të liçensohet nga Dega e Tatimit Taksave të Rrethit nëse nuk ka shlyr më parë taksat dhe tatimet vendore.

Duke filluar nga 1 janari 2001, komunat, bashkitë dhe qarqet kanë autonomi të plotë për vendosjen e tarifave vendore për kategoritë e mëposhtme:

- tarifa për shërbimet publike;
- tarifa për përdorimin e të mirave publike, me përjashtim të atyre që prodhohen nga pushteti qendror;
- tarifa administrative për licenca, autorizime, certifikata dhe dokumentacionin zyrtar.

Duke filluar nga 1 janari 2002, komunat, bashkitë dhe qarqet kanë të drejtë të marrin financime, të përcaktuara me ligj të veçantë, nga burimet e mëposhtme:

- transferta të pakushtëzuara të përgjithshme dhe barazuese;
- ndarja e taksave kombëtare;
- transferta të kushtëzuara për arritjen e objektivave kombëtare;
- ç) fonde të transferuara nga pushteti qendror komunal, bashkive dhe qarqeve për kryerjen e funksioneve të deleguara.

1. Komuna dhe bashkia financohen nga këto burime kombëtare:

- Taksat dhe tatimet e ndara, në të cilat përfshihen një pjesë e tatimit mbi të ardhurat vetjake, si dhe një pjesë e tatimit mbi fitimin e subjekteve ekonomike. Të ardhurat vjetore nga këto taksa e tatime u jepen komunave dhe bashkive në jo më pak se tri

transferta në vit. Pjesa e taksës dhe tatimit që shkon në favor të tyre, si dhe mbledhja e administrimi përcaktohen me ligj për çdo taksë ose tatim të ndarë.

- b) Transfertat e pakushtëzuara nga Buxheti i Shtetit, që jepen sipas kriterëve të përcaktuara me ligj, bazuar në funksionet dhe kompetencat e veta ose të përbashkëta të komunave dhe bashkive, si dhe për arritjen e barazisë së burimeve mes njërive të ndryshme të qeverisjes vendore në raport me mundësitë e tyre për të krijuar të ardhurat e nevojshme.
- c) Transfertat e kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit.

Shpenzimet e buxhetit Bashkiak

Sipas ligjit “Per për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, njësitë e Qeverisë Vendore kanë autoritet të plotë për të përdorur të gjitha e jera të të ardhurave, të cilat nuk janë transferta të kushtëzuara. Pjesë të këtyre fondeve, të cilat nuk janë përdorur gjatë vitit financiar, mund të mbarten në vitin financiar pasardhës..

Buxheti planifikohet sipas Manualit të Buxhetit, i cili i dërgohet Bashkive me dokumentin nr.3820 datë 03/08/1999 i Ministrisë së Financave dhe dokumentit nr.4569 datë 15/08/1999 të Ministrisë së Pushtetit Lokal.

Planifikimi i të ardhurave vjetore nga taksat dhe tatimet, të cilat do të përfshihen në buxhetin vjetor, përgatitet mbi bazën e të dhënave alternative dhe të dhënave respective historike, duke marrë parasysh të ardhurat nga tre vitet e mëparshme, si edhe të ardhurat aktuale të gjashtë muajve të vitit actual, duke llogaritur veçmas secilin element të të ardhurave.

Shpenzimet bashkiake behen kryesisht për:

1. mirëmbajtjen dhe riparimin e kopshteve bashkiake dhe ndersave shkollore,
2. transportin vendor publik,
3. riparimin e rrugëve vendore,
4. ndërtimin e sitemit të ujërave të zeza,
5. kontributet për ambientet kulturore,
6. rrogat e zyrtarëve dhe punonjësve të tjerë bashkiak, duke përfshirë pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Disa nga Bashkitë më të mëdha dhe më të vogla në Shqipëri

Bashkia	Popullsia	% ne raport me Pop totale te Bashkive
Tirana	455,201	22.4
Durrës	130,170	6.4
Elbasan	116,560	5.7
Vlorë	107,451	5.3
Shkodra	106,415	5.2

Fier	80,804	4
Korça	79528	4
Berat	64,394	3.2
Lushnjë	55,652	2.7
Kamëz	45,545	2.2
Kavajë	34,431	1.7
Pogradec	33,559	1.7
Patos	33,083	1.6
Gjirokastrë	33,022	1.6
Sarandë	31508	1.6
Kuçovë	30,749	1.5
-----	-----	-----
Këlcyrë	4,718	0.2
Libohovë	3,042	0.1
Leskovik	2,945	0.1
Konispol	2,932	0.1
Totali	2,033,220	100

Por aktualisht popullsia e qyteteve te medha eshte me e madhe sesa ajo e paraqitur ne table, kjo gje ndodh dhe per qytetet e vogla. Ne Tirane jane me shume se 150.000 banorë në rrethinët e tij.

Struktura tëritorialë e Komunave, bashkive dhe Rajoneve ne Shqiperi.

NR	RAJONE	BASHKI	KOMUNA	FSHATRA TË PËRFSHIRA NË BASHKI	FSHATRA TË PËRFSHIRA NË KOMUNA	QYTETE
01.	BERATI	5	20	+ 6	239	5
02.	DIBRA	4	31	+ 15	264	7
03.	DURRESI	6	10	+ 21	85	6

PJËSËMARJA E QYTETARËVE NË VETQEVERISJEN VENDORE

- Zgjedhjet Vendore
- Format e pjesëmarjes direkte-referendumet.

Kushtetuta e Shqipërisë vendosi që njësitë e qeverisjes vendore të zgjidhen cdo tre vjet nga zgjedhje të përgjithshme me votë të fshehtë. Kufijtë e këtyre njësitë nuk mund të ndryshohen pa marrë së pari opinionin e banorëve të tyre. Duke u bazuar në Ligjin bazë, misioni i njësitë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë është të sigurojë një qeverisje në nivel sa më afër shtetasve dhe kryesisht nëpërmjet nxitjes efektive të banorëve në qeverisjen vendore.

Mbledhja e Këshillit duhet të jetë e hapur për publikun dhe cdo qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje. Përpara se të diskutohen dhe të aprovohen aktet e tij, këshilli organizon mbledhje të hapura të cilat janë të detyruara në rastet kur:

- Zgjedh dhe heq Kryetarin e Këshillit, Zv Kryetarin dhe Sekretarin e Këshillit.
- Miraton buxhetin vjetor
- Aprovohen ndryshimet në buxhetin e vet ose kur jep në përdorim të tretëve.
- Vendos kuotat e taksave vendore dhe të tarifave vendore.
- Miraton norma , standarte dhe kritere për rregullimin dhe përforcimin e funksioneve etj.

Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore.

Organet vendore mund të bashkeveprojnë për mbrojtjen e interesave të përbashkëta.

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon që organet e njësitë të qeverisjes vendore kanë të drejtën të formojnë bashkime dhe institucione të përbashkëta me njëri tjetrin për përfaqësimin e interesave të tyre.

Shoqata e pare e Kryetarëve të Bashkive u miratua nga Ministria per Problemet e Pushtetit Lokal më nr.prot 3022 dt.12.10.1993 me kërkesën e një grupit nismetar të përbarë nga 10 Kryetarë Bashkie në bazë të ligjit Nr.2362 datë16.11.1956 "Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike"

Në datën 1.09.1994 zgjidhet Komiteti Drejtues dhe respektivisht:

- | | |
|-------------------|----------------------|
| 1. Sali Kelmendi | Kryetar (Tiranë) |
| 2. Filip Guraziu | Nënkryetar(Shkodër) |
| 3. Elham Sharra | Nënkryetar (Vlorë) |
| 4. Bashkim Fino | Anëtar (Gjirokastër) |
| 5. Ali Zeneli | Anëtar (Burrel) |
| 6. Tomorr Golemi | Anëtar (Durrës) |
| 7. Gjergji Gjinko | Anëtar (Korcë) |

Në atë kohë filluan kontaktët e para si brenda dhe jashtë vendit për të afirmuar sado pak pozicionin e saj por mungesa e personelit të përhershëm nuk do ta lejonte të luante një rol aktiv rritjen e shkallës së bashkëveprimit me Anëtarët.

Në vitin 1996 zgjidhet Komiteti i ri Drejtues:

- | | | |
|------------------|---------|----------|
| 1. Albert Brojka | Kryetar | (Tiranë) |
|------------------|---------|----------|

2. Bahri Borici	Nënkryetar	(Shkodër)
3. Milika Jaho	Nënkryetar	(Berat)
4. Artur Kurti	Anëtar	(Kucovë)
5. Engjell Dakli	Anëtar	(Elbasan)
6. Arqile Goreja	Anëtar	(Durrës)
7. Ylli Asllani	Anëtar	(Gjirokastër)
8. Agron Milaj	Anëtar	(Fier)
9. Dhionis Kotmilo	Anëtar	(Korcë)
10. Safet Sula	Anëtar	(Kukës)
11. Capajev Zeraj	Anëtar	(Sarandë)

Me gjithëse vazhdimësia e punës së Shoqatës vështiresohej si nga aspekti organizativ ashtu dhe nga aspekti financiar vetë antarët e saj në bashkëpunim dhe me Shoqatën e Bashkive Hollandeze VNG nëpërmjet një projekti të iniciuar nga këta të fundit bënë te mundur ngritjen e një stafi organizativ (2 persona) dhe pajisjen e këtij stafi me zyra dhe me mjetet e nevojshme për punë në fillim të vitit 1999.

Asambleja e Përgjithshme në 5 Shtator të 2000 ndryshoi emrin në Shoqata e Bashkive të Shqipërisë (SHBSH)si dhe adoptoi se bashku me emrin e ri edhe statutin e ri të Shoqatës.

Sipas statutit Asambleja e Përgjithshme është organi suprem i SHBSH. Asambleja mbledhet një herë në vit; cdo bashki përfaqësohet nga dy persona, Kryetari i Bashkise dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak. Në Asamblenë e Përgjithshme zgjidhen Kryetari, Kryesia dhe Komiteti Drejtues. Komiteti Drejtues drejton aktivitetet e Shoqatës gjatë periudhës ndërmjet dy Asambleve të Përgjithshme si dhe emëron Drejtorin Ekzekutiv, Financierin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të SHBSH.

Misioni i SHBSH është të mbrojë interesat e përbashkëta të bashkive shqiptare me qëllim arritjen dhe zhvillimin e demokratizimit dhe decentralizimit të vërtetë të qeverisjes vendore sipas parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore.

Qëllimet kryesore të SHBSH janë:

- Të mbrojë interesat e përbashkëta të Bashkive Shqipëtare.
- Të vendosë lidhje të drejtpërdrejta me Kuvendin e R.SH, Qeverinë për mbrojtjen e interesave të organeve të vet qeverisjes vendore.
- Të përfaqësojë bashkitë shqiptare në marrëdhëniet me organizma të tjera.
- Të mundësojë diskutimin e problemeve të përbashkëta me forumet e shoqatës me qëllim gjetjen e zgjidhjeve praktike.
- Të lehtësojë vendosjen e kontakteve midis bashkive dhe partnerëve të tyre jasht vendit.
- Të realizojë shërbime të ndryshme ndaj bashkive duke ofruar trajnime dhe kualifikime.

Nje nga misionet e saj është dhe mbrojtja e interesave të përbashkëta kur vëren se nëne të vécanta të legjislacioni cënojnë autonominë vendore . Shoqata i ka drejtuar disa here Gjykatës Kushtetuese kërkesa për shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave si dhe për Ligje që bien ndesh me Kushtetutën duke e bindur këte ti anullojë ato.

Permendim kërkesën për kundërshtimin e VKM Nr.161 datë 11.03.96 "Për Organizimin e Strukturave të Gjendjes Civile" ecila u morr parasysh nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjendja Civile ju dha përsëri Bashkive , apo kërkesën per kundërshtimin e Ligjit Nr. 8405 dt.17.09.1998 (Për Urbanistikën). Gjykata Kushtetuese anulloi disa nene duke zgjidhur këtë problem kaq të rëndësishëm .

Në Nëntor të vitit 1999 me ndihmën e VNG del për herë të parë Gazeta e Bashkive i cili u jep informacion anëtareve si dhe shoqatave joqeveritare për probleme të pushtetit lokal. Më iniciativën e stafit të Shoqatës dhe mbas disa bisedimeve u arrit të bindeshin donatorët e huaj (OSBE, VNG, Institutin Urban dhe Projekti PAPA) që shoqata të ishte drejtuesja e organizimit të 7 Tryezave të Rrumbullakëta në 7 Qytete të Shqipërisë me Kryetarë të punonjës bashkie për projekt ligjin "Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal". Mbas përpunimit të gjitha vërejtjet ja dërguam këto Grupit Teknik të Ekspertëve të Decentralizimit (Task Force) dhe pjesa dërmuese e tyre u pasquruan të plota në Ligjin në fjalë gjë që sipas mendimit të specialistëve sot do të shtonin telashet për pushtetin lokal.

Me miratimin e "Kodit Zgjedhor" nga Parlamenti stafi përgatiti një projekt të hollësishëm për sqarimin e të zgjedhurëve vendore mbi disa probleme të hasura në zbatim të këtij Kodi dhe me Fondacionin "Hanns Seidel" organizoi 5 takime në 5 qytete të Shqipërisë ku përveç punonjësve të Bashkive u ftuan dhe një pjesë e Komunave. Në bashkëpunim me Projektin e Administratës Publike në Shqipëri (PAP/A) dhe me mbështetjen e Fondacionit SOROS u organizua një Ekspozitë e Ideve në Veprim (Përgatitja e Pushtetit Lokal për shekullin e 21-të) në 5-6 Shtator 2000.

Komiteti drejtues përbëhet nga:

Në Asambleenë e Përgjithshme të mbajtur më 20 Dhjetor 2000 u zgjodh Komiteti Drejtues i Shoqatës.

1. Edi Rama	Kryetar	Kryetar i Bashkisë Tiranë
2. Artur Kurti	Nënkryetar	Kryetar i Bashkisë Kucovë
3. Ndoc Cefa	Nënkryetar	Kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër
4. Miri Hoti	Anëtar	Kryetar i Bashkisë Durrës
5. Hysen Domi	Anëtar	Kryetar i Bashkisë Elbasan
6. Gëzim Dauti	Anëtar	Kryetar i Bashkisë Bulqizë
7. Nikolla Kashovari	Anëtar	Kryetar i Bashkisë Fier
8. Gjergji Duro	Anëtar	Kryetar i Bashkisë Korçë
9. Ylber Zeneli	Anëtar	Kryetar i Bashkisë Kukës
10. Marie Biba	Anëtar	Kryetare e Bashkisë Rrëshen
11. Elvira Shaplo	Anëtar	Kryet. e Kësh. Bashkiak Gjirokastrë
12. Mërkur Cukalla	Anëtar	Kryet. i Kësh. Bashkiak Memaliaj
13. Astrit Kuqi	Anëtar	Kryet. i Kësh. Bashkiak Pukë
14. Fatbardha Shabanaj	Anëtar	Kryet. e Kësh. Bashkiak Vlorë

Aktivitetet gjatë vitit 2000.

1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimit dhe me mbështetjen e Fondacionit "Hanns Seidel" organizon seminare për tatim taksat vendore në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Pogradëcit, Kucovës, Vlorës dhe Gjirokastrës.
2. Me mbështetjen e Programit KOMPAS realizon një tavolinë të rrumbullaktë për Projekt-ligjin "Për Prefektin".
3. Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike, me Co-PLAN dhe me mbështetjen e Fondacionit "Hanns Seidel" organizon seminarin "Menaxhimi Urban".
4. Me mbështetjen e Programit KOMPAS realizon një tavolinë të rrumbullaktë për Udhëzuesin e Lejeve të Ndërtimit.

